

Raport Muaji Shkurt 2025

Informacion bazë

Administrimi i Fondit	Shoqëria Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	Euro
Datë Lancimi	22 Nentor 2012
Vlera fillestare e kuotës	100
Shuma fillestare minimale	250
Shuma minimale pasuese	50

Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	0.00%
Tarifë në dalje	0.00%
Tarifë Administrimi në vit	Deri ne 1.30% e vleres neto te aseteve

Tarifa te tjera te vazhdueshme **Referojuni prospektit te fondit**

Komisione/tarifa të vazhdueshme **1.48% per vitin 2024**

Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta **Referojuni informacionit ne deget e RBAL**

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të mund t'i sigurojë investitorit një kthim nga investimi në perputhje me një menaxhim të kujdesshëm të portofolit duke ruajtur nivelin e kapitalit dhe likuiditetit të nevojshëm.

Nje pjese e rendesishme e aseteteve te fondit mund te investohen ne bono dhe obligacione thesari te Qeverise se Republikes se Shqiperise, te emtuara ne monedhen euro. Megjithate, frekuenca e emetimeve ne euro nga Qeveria e Republikes se Shqiperise do te percaktoje shkallen ne te cilen Fondi do te investoje ne keto lloj instrumentash.

Fondi eshte i pershtatshem per individe dhe subjekte juridike te cilet mendojne se objektivi i investimit i Fondit perputhet me kerkesat dhe pritshmerite e tyre.


Shifra e tarifave të vazhdueshme 1.48% mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2024. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifa totale e vazhdueshme nuk mund të kalojë maksimumin prej 1.6% ne vit te vlerës neto të aseteteve te fondit.

Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëvendërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit.

Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë
Përfitimet tipike më të larta



Fondi Raiffeisen Invest Euro është në kategorinë e tretë të Profilit të Riskut dhe Përfitimit

Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk.

Ky tregues ka për qëllim tju informoje mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 28 Shkurt 2025


Vlera Neto e Aseteve	€ 40,500,402
Numri I Investitoreve	1,693
Cmimi I Kuotes	116.3570
*Kthimi Vjetor nga Investimi (29.02.2024 – 28.02.2025)	4.49%

*Tarifa e administrimit dhe tarifata të tjera të vazhdueshme zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.

Struktura e Portofolit të investimeve më 28 Shkurt 2025

Portofoli i fondit Euro është ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga balancimi i kategorive të ndryshme të investimeve në bono dhe obligacioneve qeveritare dhe të korporatave. Kjo bëhet me qëllim për të diversifikuar portofolin dhe ulur riskun që vjen nga ekspozimi i gjere ndaj pak instrumenteve.

Përqindja e alokimit të asetëve bëhet në përputhje me politikën e investimit dhe kriteret e specifikuar në prospektin e fondit. Shpërndarja e asetëve mund të jetë jashtë objektivit të përcaktuar për shkak të ndryshimeve të kushteve të tregut. Asetet e Fondit janë të investuara në instrumente financiare që i përkasin emetuesve që performojnë në industri të ndryshme të ekonomisë duke bërë të mundur rritjen e diversifikimit të portofolit.




Duke iu referuar strukturës së portofolit të investimeve të fondit më 28 shkurt 2025, përqindja e asetëve të fondit e investuar në Obligacione Shtetërore është në 56.7% të asetëve dhe 39.4% i përkasin obligacioneve të emetuara nga Qeveria Shqiptare. Fondi mund të balancojë ekspozimin ndaj instrumenteve të ndryshme në varësi të kushteve të tregut për të arritur objektivat e tij afatgjatë. Asetet e fondit të investuara në obligacione korporatash me vlerësim të lartë dhe në fonde investimesh përbëjnë 50.8% të totalit të aktiveve. Keto fonde investimi gjithashtu kanë në fokus investime në tregun e obligacioneve. Likuiditeti i mbajtur në cash dhe depozita është rritur në nivelin 3.9% e totalit të asetëve të fondit. Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin 40.5 milionë EUR në fund të muajit shkurt.

Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës gjate muajit Shkurt


Gjatë muajit shkurt, çmimi i kuotës së fondit ka pësuar rritje me **0.96%**. Yield-et e obligacioneve ranë në të gjithë SHBA-në, pasi investitorët u përqendruan drejt asetëve më pak rrisht, ndërsa tregjet europiane ofruan kthime modeste. Si rrjedhojë, performanca e obligacioneve qeveritare dhe atyre të korporatave pati një efekt pozitiv në portofolin e investimeve të fondit Raiffeisen Invest Euro, i cili regjistroi fitime përgjatë muajit. Yield-i mesatar i portofolit të investimeve të fondit ishte 3.41% për një kohëzgjatje mesatare prej 3.26 vjet më 28 shkurt.

Kthimi neto vjetor i fondit është +4.49% më 28 shkurt 2025.



Ne dt 28 Shkurt 2025	1 Vit	2 Vite	3 Vite	5 Vite	10 Vite	Nga lancimi (22 Nentor 2012)
Kthimi ne % p.a per periudhen	+4.49%	+4.56%	0.99%	-0.63%	+0.78%	+1.24%

Kthimi Neto i fondit Raiffeisen Invest Euro per çdo vit



Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut dhe çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Luhatshmëria është pjesë e natyrshme e fondeve te investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur.

Investitorët e fondit Raiffeisen Invest Euro dhe te gjithe fondeve te administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate investimi per te perfituar nje kthim optimal nga investimi dhe ne kete menyre ne periudhe afatmesme apo afatgjate te kene mundesi te rikuperojne edhe efektet negative te krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen që të ruajnë investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qëndrimit në fond të nxitur nga situatat jo të zakonshme të krijuara për kohëzgjatje në tregjet financiare, sepse në këtë mënyrë nuk do të riskojnë të dalin nga fondi në momentin e gabuar për investimin e tyre.

Zhvillimet dhe informacion mbi ecurinë e tregjeve financiare gjatë muajit Shkurt

Inflacioni i Eurozonës ra në nivelin 2.4% në shkurt, më i ulët se vlera 2.5% e janarit, por më i lartë se sa pritej nga ekonomistët e anketuar nga Reuters. Inflacioni bazë, i cili eliminon kostot e energjisë, ushqimit, alkoolit dhe duhanit, arriti në 2.6% në shkurt, gjithashtu më i ulët se rezultati i janarit.

Indeksi i çmimeve të konsumit në të gjithë ekonominë amerikane, u rrit me 0.5% për muajin janar, duke e vendosur normën vjetore të inflacionit në 3%. Norma vjetore ishte 0.1 pikë përqindjeje më e lartë se muaji dhjetor. Inflacioni bazë u rrit me 0.4% në muaj, duke e vendosur normën e inflacionit 12-mujor në 3.3%. Norma bazë vjetore gjithashtu u rrit me 0.1 pikë përqindjeje nga dhjetori.

Inflacioni u rrit më shumë se sa ishte parashikuar në janar, duke i dhënë një nxitje të mëtejshme Rezervës Federale për të mbajtur normat e interesit në të njëjtin nivel. Procesverbalet nga takimi i FOMC i janarit treguan se politikëbërësit duan të shohin "progres të mëtejshëm mbi inflacionin" përpara se të shqyrtojnë çdo ulje të mëtejshme të normës.

Banka Qendrore Evropiane ka shumë të ngjarë të ulë përsëri normat e interesit me 25 pikë në takimin e marsit, duke ulur kështu normat për të gjashtë herë që nga qershori. Megjithatë, periudha e uljes së normave ndoshta po i afrohet fundit, ndërsa inflacioni ngadalësohet dhe ekonomia haset me ndryshime të konsiderueshme gjepolitike.

Ngjarjet në Europë tërhiqën vëmendjen, duke përfshirë zgjedhjet gjermane, ku Kristian Demokratët (CDU/CSU) të udhëhequr nga Friedrich Merz shpallën fitoren. Për më tepër, diskutimet e vazhdueshme mbi luftën në Ukrainë ngritën pikëpyetje në lidhje me shpenzimet e mbrojtjes në të gjithë Europën, dhe përdorimi agresiv i tarifave si kërcënim nga administrata Trump rriti gjithashtu pasigurinë në tregje.

Ndërsa investitorët u përqendruan drejt asetëve më pak rrishtës, obligacionet qeveritare të SHBA u favorizuan, duke shkaktuar rënie të yield-ëve (yield-et lëvizin në drejtim të kundërt me çmimet). Në frontin e obligacioneve të korporatave, kushtet e tregut ishin më pak të favorshme. Investitorët filluan të perceptonin nivel më të lartë rrishtës, shkaktar ky që spread-et e obligacioneve të korporatave (diferenca në yield midis obligacioneve të korporatave dhe atyre të qeverisë) të zgjerohen. Kjo ndodhi në tregjet e obligacioneve me vlerësim të lartë, por edhe në tregjet e obligacioneve me yield të lartë. Obligacionet e thesarit të SHBA-së performuan më mirë se tregjet e tjera botërore të obligacioneve qeveritare. Tregjet evropiane të obligacioneve qeveritare dhuruan kthime modeste: obligacionet 10-vjeçare gjermane me yield 2.39%, obligacionet qeveritare 10-vjeçare spanjolle 3.10% dhe obligacionet 10-vjeçare italiane 3.47%.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjerë numerikë janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analizë të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit. Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sh.a., në faqen zyrtare www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.